

1. ÇFARË NËNKUPTON STATUSI OEA?

Operatori Ekonomik i Autorizuar (OEA) është një status i lëshuar për "bizneset me besueshmëri" të cilët mund të përfitojnë nga shumë thjeshtime doganore dhe që ndërtohet në parimet e transparencës, korrektesisë dhe përgjegjësisë reciproke.

Koncepti OEA bazohet në partneritetin doganë-biznes me qëllim që operatorët ekonomikë, me vullnet të lirë, të plotësojnë një sëri standartesh për të garantuar objektivin e përbashkët të sigurisë së zinxhirit të furnizimit.



2. KUSH MUND TË APLIKOJË PËR STATUSIN OEA?

Sipas përcaktimeve të nenit 40 të Kodit Doganor (KD), pika 1, një operator ekonomik i cili është i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe përbush kriteret e vendosura në nenin 41 të KD, mund të aplikojë për statusin e operatorit ekonomik të autorizuar.

Programi i OEA është i hapur për të gjithë operatorët ekonomikë, duke përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme pavarësisht nga roli i tyre në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit.



3. SI MUND TË APLIKOJ PËR STATUSIN OEA DHE CILËT JANË HAPAT E PARË PËR FILLIMIN E KËTIJ PROCESI?

Çdo operator ekonomik që shfaq interesi për t'u pajisur me statusin OEA mund të aplikojë në dy mënyra:

- Në protokollin e DPD (hard copy);
- Online (në adresën e-mail - lehtesimedoganore.dpd@dogana.gov.al)

Hapi i parë për fillimin e kësaj procedure është plotësimi i Aneksit 12 (formular aplikimi) dhe Aneksit 13 (pyetësori i vetëvlerësimit), të cilët duhet të plotësohet në mënyrë të detajuar duke u referuar gjithmonë tek shenimet shpjeguese në fund sipas çdo seksioni të tyre.



5. CILI ËSHTË HISTORIKU I PROGRAMIT OEA NË SHQIPËRI?




7. CFARË NËNKUPTON MARRËVESHJA PËR NJOHJEN E PËRBASHKËT TË OEA DHE CILAT JANË PËRFITIMET?

Njojja e përbashkët përfshin faktin që administrata doganore e një vendi njeh autorizimin OEA të lëshuar nga programet e tjera dhe është dakord të ofrojë përfitime/lehtësi të rëndësishme, të krasueshme dhe aty ku është e mundur reciproke për OEA-në e njojur reciprokisht.

PËRFITIMET:

- Numër më të kufizuar kontrollësh fizike dhe dokumentare.
- Thjeshtime në inspektime në lidhje me të gjitha procedurat e zhdoganimit dhe reduktim të procedurave në masën maksimale të mundshme;
- Shkëmbime të dhënash midis autoriteteve doganore në masën që lejon çdo legjislacion kombëtar
- Njojje reciproke të programeve kombëtare të OEA-ve në çdo palë të CEFTA-s, me kusht që legjislacioni dhe zbatimi i çdo programi kombëtar të jenë në përpunim të plotë me legjislacionin përkates të BE-së.

4. CILAT JANË LLOJET E CERTIFIKATAVE OEA?



6. CILAT JANË BENEFITET E MBAJTËSIT TË STATUSIT OEA?

- Më pak kontolle fizike dhe të dokumentarë në krasim me operatorët e tjera
- Trajtim prioritar dhe njoftim paraprak në rast selektimi për kontroll doganor
- Akses më i lehtë për thjeshtime doganore
- Zgjedhja e vendit ku do të bëhet kontrolli doganor
- Marrëdhënie më të mira me autoritetet doganore dhe autoritete të tjera shtetërore
- Njojje reciproke me vende të tjera
- Përfitime të tjera indirekte

8. A MUND TË JETË NJË KËSHILLTAR I JASHTËM I KOMPANIËS PIKË KONTAKTI PËR ADMINISTRATËN DOGANORE NË FUNKSION TË STATUSIT OEA?

Pikë kontakti e një operatori ekonomik për autoritetet doganore duhet të jetë një punonjës me kohë të plotë i kompanisë, me njojuri dhe kompetencë mbi procedurat doganore.

Personi, kompani të këshillimit apo agjentët doganorë mund të suportojnë në çdo rast kompaninë në funksion

të përbushjes së gjithë procedurës së aplikimit për statusin OEA dhe dokumentacionit të nevojshëm.



9. CILAT JANË KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJ PËR T'U PAJISUR ME CERTIFIKATË OEA?



1. Konformiteti - gjatë 3 viteve të fundit, aplikuesi (operator ekonomik), drejtuesi apo drejtuesit e tij, si punonjësi i ngarkuar me çështjet doganore të aplikuesit, nuk ka kryer shkelje serioze ose shkelje të përsëritura të legjisacionit doganor dhe tativor dhe nuk ka kryer vepra penale që lidhen me veprimitarët e tij ekonomike;

2. Të disponojë sistem efikas të menaxhimit të dhënave tregtare dhe të transportit- të demonstrojë një nivel të lartë kontrolli të lëvizjes së mallrave me anë të një sistemi që menaxhon regjistrimet tregtare dhe, kur është me vend, edhe regjistrimet e transportit, i cili lejon kryerjen e kontrolleve të duhura doganore.



10. NË CILAT RASTE REFUZOHET APLIKIMI PËR STATUSIN OEA?

Një aplikim për përfitimin e statusit OEA refuzohet në rast se nuk plotësohet 1 apo disa nga kushtet e parashikuara nga numri 41 i Kodit Doganor. Refuzimi i aplikimit për OEA nuk cënon vendimet e favorshme të marra në lidhje me aplikuesin, në përputhje me legjisacionin doganor ekzistues, përveç rasteve kur dhënia e këtyre vendimeve të favorshme është bazuar në përbushjen e ndonjë prej kriterieve OEA që provohen se nuk janë përbushur gjatë shqyrtimit të aplikimit OEA.



11. CILAT JANË FUSHAT QË KONTROLLOHEN GJATË VIZITAVE NË KOMPANI NGÀ GRUPI I VALIDIMIT/AUDITIMIT?

3. Të ketë aftësi paguese financiare të provuara me pasqyrat financiare të 3 viteve të fundit;

- PROCEDURAT DOGANORE;
- SISTEMIN IT/CCTV;
- KUSHTET E SIGURISË;
- ANALİZËN E RISKUT;
- ASPEKTET FINANCIARE;
- BURIMET NJERËZORE;
- PROSESET LOGISTIKE.



4. Të plotësojë standaret praktike të kompetencave ose kualifikimet profesionale;

5. Të plotësojë standaret e sigurisë dhe të mbrojtjes (në rastet kur aplikohet për OEA-S).

12. KUR DHE SI MUND TË REVOKOHET/ANULOHET STATUSI OEA PËR NJË KOMPANI?

Autoritetet doganore anulojnë autorizimin e OEA-së nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) Vendimi për autorizimin e OEA-së është marrë mbi bazën e informacioneve të pasakta dhe të plapota;
- b) OEA-ja kishte dijeni ose duhej të ishte në dijeni se informacioni ishte i pasaktë ose i paplotë;
- c) Nëse informacioni do të ishte i saktë dhe i plotë, vendimi për autorizimin e OEA-së do të ishte ndryshe.



13. KU DHE SI MUND TË DREJTOHEMI PËR MARRJEN E INFORMACIONIT APO PAQARTËSI QË MUND TË KEMI NË LIDHJE ME KËTË PROCES?

Në website-n zyrtar të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave gjendet një dritarë e dedikuar vetëm për OEA-të (<https://dogana.gov.al/c/170/284/operator-ekonomike-te-autorizuar>).

Gjithashtu, për çdo pyetje apo paqartësi mund të shkruani edhe në adresën e e-mail lehtesimedogano.dpd@dogana.gov.al.



14. CFARË ROLI MUND TË KETË MBAJTËSI I STATUSIT OEA NË ZINXHIRIN NDËRKOMBËTAR TË FURNIZIMIT?

14. CFARË ROLI MUND TË KETË MBAJTËSI I STATUSIT OEA NË ZINXHIRIN NDËRKOMBËTAR TË FURNIZIMIT?

- PRODHUES
- IMPORTUES/EKSPORTUES
- AGJENCI SPEDICIONERE
- AGJENCI DOGANORE
- TRANSPORTUES
- MAGAZINIM



15. MBAJTJA E STATUSIT OEA SUPONON ELEMINIMIN E ÇDO LLOJ KONTROLLI NGÀ AUTORITETET DOGANORE SHQIPTARE?

15. MBAJTJA E STATUSIT OEA SUPONON ELEMINIMIN E ÇDO LLOJ KONTROLLI NGÀ AUTORITETET DOGANORE SHQIPTARE?

Mbaftja e statusit të OEA nuk suponon eleminimin e të gjitha kontrollave doganore por reduktimin maksimal të tyre. Autoritetet doganore mund të vendosin të ushtrojnë kontolle duke marrë në konsideratë një rrezik specifik apo detyrimet për kontroll sipas përcaktimeve në ligjet specifike (p.sh. legjisacioni që lidhet me sigurinë e produktit).



PYETJET MË TË SHPESHTA PËR STATUSIN OEA